

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | FAZ: Mbi 100 ditë protestë në Tiranë, por “Revolucioni i Flamingove” mbetet larg një lëvizjeje masive                                                                                                                                                                                   |
| ADRESA  | <a href="https://prapaskena.com/2026/09/18/faz-mbi-100-dite-proteste-ne-tirane-por-revolucioni-i-flamingove-mbetet-larg-nje-levizjeje-masive/">https://prapaskena.com/2026/09/18/faz-mbi-100-dite-proteste-ne-tirane-por-revolucioni-i-flamingove-mbetet-larg-nje-levizjeje-masive/</a> |
| BURIMI  | prapaskena.com                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                                                  |

## KOHA


|                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE     | 18 shtator 2026, 18:39:59 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                                                                                                                                                                                                                                          |
| LEXUAR NGA FAQJA | 17 shtator 2026, 22:00:00 UTC<br><i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën <b>text_date</b>. Dritarja: 17 shtator 2026, 21:59:00 UTC → 17 shtator 2026, 22:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 790a158162686571745054bce65d938aaf8411b06784b7a25bf6fb3b17949661 |
| TEKSTI     | 49a97a46ff1c7dc59da7bcee6848ecd77db21b95e08c05803507a15152e85edc |
| PAMJA      | d07e7827425e5fa132056f6db7f3e7a25ba7b90709c07d388c883efdf68601c3 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 6fbf3ce043d754a6d214e6f81f95637adda046e7f280a9b8d9e411ab4bd7096                                 |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 214493168e8eaddb39b9693f5adfa0b73b0dd908a9438af0217b4721b8b2f352                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6fbf3ce043d754a6d214e6f81f95637adda046e7f280a9b8d9e411ab4bd7096>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



# F AZ: Mbi 100 ditë protestë në Tiranë, por “Revolucioni i Flamingove” mbetet larg një lëvizjeje masive

Aktualitet

Publikuar: 18/09/2026

f X



**G**azeta gjermane analizon protestën kundër qeverisë Rama dhe vëren se, me gjithë këmbënguljen, ajo nuk ka arritur të marrë përmasat e një revolte popullore. Kryeministri e sheh situatën si një “provë besimi” dhe argumenton se pakënaqësia është edhe pasojë e pritshmërive më të larta në një shoqëri që ka ndryshuar.

**Nga Matthias Rüb, Frankfurter Allgemeine Zeitung**

Prej më shumë se njëqind ditësh ata mbledhen çdo mbrëmje. Rreth orës 19:00 njerëzit grumbullohen në zemër të Tiranës dhe ecin përgjatë Bulevardit “Dëshmorët e Kombit”. Afërsisht në gjysmën e rrugës ndodhet zyra e kryeministrit, dorëheqjen e të cilit kërkojnë. Pikërisht aty protesta bëhet më e zhurmshme. Hera herës, para godinës ka përplasje me efektivët e policisë dhe arrestime, por shumicën e kohës situata mbetet paqësore.

Kështu ndodh mbrëmje pas mbrëmjeje. Gjatë ditëve të javës, protestuesit janë dukshëm më të shumtë në numër sesa në fundjavë, kohë kur edhe protestuesit më këmbëngulës zgjedhin

## Me të lexuarat

Biznesmeni

Yzedin Bozhaj kapet duke vjedhur paratë publike në bashkëpunim me një merrandratë...

shtëpi dhe disa garazhe, 2 mikeshat nga Durrësi do vendosin për çoi padashje një video...

pornografike në një bisedë me shoqet, si u zbulua abuzimi i 12-vjeçares gjyqtarja...

Eherjeta Shehaj skemë korrupsioni me burrin avokat që u shkarkua nga detyra me komandën...

KQZ: Si ndërhyri Sekretarja në sistem për favorizuar kompaninë e vëllain e...

ndonjëherë detin, në vend që të qëndrojnë gjithmonë në rrugët e Tiranës. Këto të fundit mbushen nga të rinjtë që dalin për të festuar. Ata festojnë të paktën po aq zhurmshëm dhe gjatë sa protestuesit demonstrojnë. Janë dy botë paralele që duket sikur nuk priten me njëra-tjetrën.

I vetëshpalluri “Revolucion i Flamingove” në Shqipëri, deri tani nuk është shndërruar në një lëvizje masive. Megjithatë, ka treguar këmbëngulje. Të njëjtën gjë po bën edhe kreu i qeverisë Edi Rama. Ai është në pushtet që prej vitit 2013 dhe është i vendosur të qëndrojë deri në fund të legjislaturës në vitin 2029. Cila palë do t’ia dalë të rezistojë deri në fund?

Protestat në kryeqytetin shqiptar nisën në fund të majit. Shkak u bë ndërhyrja e ashpër e punonjësve të një kompanie private sigurie pranë një gardhi kantieri. Gardhi ishte ngritur në skajin verior të gadishullit të Zvërnecit, ku do të nisin punimet paraprake për një projekt turistik luksoz.

Kundër projektit, që po shtyhet përpara nga kompania e investimeve Affinity Partners e Jared Kushnerit, dhëndrit të Donald Trumpit, kishin protestuar në vend disa qindra persona. Gjatë protestës pati përplasje pranë gardhit. Rojet tërhoqën zvarrë disa protestues mbi zhavorr për t’i larguar nga gardhi i kantierit. Pamjet e regjistruara me celular të ndërhyrjes, ku askush nuk u lëndua rëndë, u bënë virale.

Por si mundi një incident relativisht i parëndësishëm të shndërrohej në një lëvizje proteste kombëtare, që madje e quan veten revolucion? Kjo lidhet edhe me flamingot, të cilët lëvizja i ka zgjedhur si simbolin simpatik të ndryshimit që synon. Ambientalistët druhen se kolonitë e flamingove rozë dhe të shpendëve të tjerë shtegtarë mund të rrezikohen nga bumi turistik në jug të Shqipërisë – veçanërisht nga resortet luksoze të planifikuara nga investitorët arabë dhe nga Katari të lidhur me grupin e Kushnerit. Habitatit i flamingos rozë është pikërisht Laguna e Nartës, një zonë e mbrojtur pranë Zvërnecit. Lëvizja e Flamingove e akuzon qeverinë për korrupsion dhe kërkon zgjerimin e zonave të mbrojtura, fundin e favorizimit të investitorëve të mëdhenj dhe zgjedhje të reja demokratike.

Fillimisht Rama, i cili drejton Partinë Socialiste që prej vitit 2005 dhe qeverinë që prej vitit 2013, u përpoq t’i linte protestat të vetëkonsumoheshin. Protestuesve u tha se nuk mund të shfaqeshin një ditë të bukur dhe të rrëzonin nga detyra kryeministrin e zgjedhur dhe qeverinë e tij. “Kështu nuk funksionon. Duhet të prisni deri në zgjedhjet e ardhshme.”

Ishte një argument i vështirë për t’u hedhur poshtë. Në zgjedhjet parlamentare të majit 2025, Rama dhe socialistët e tij kishin fituar më shumë se 52 për qind të votave. Ishte fitorja e katërt radhazi e socialistëve në zgjedhje, ndërsa Rama dhe partia e tij kishin rritur vazhdimisht nërindien e votave

Megjithatë, pikërisht pasi kishte marrë mandatin më të fortë nga zgjedhësit, Rama u përball papritur me kërcënimin më serioz ndaj pushtetit të tij. Pak më pak se dy muaj pas nisjes së protestave, ai ndryshoi taktikë. Në vend që t'u tregonte më tej "grushtin" protestuesve nëpërmjet retorikës, tani po përpiqet t'u rrahë shpatullat. Protestat, thotë tani, janë shenjë e vitalitetit dhe stabilitetit të demokracisë shqiptare.

Ai bën dallimin mes atyre që paraqesin kërkesa legjitime dhe duhen dëgjuar, dhe atyre që, sipas tij, po përdoren nga kundërshtarët e tij brenda dhe jashtë vendit për qëllime politike.

Në një fjalim të fortë para grupit parlamentar të socialistëve në fund të korrikut, Rama paraqiti strategjinë e re të qeverisë. Ai foli për një krizë të thellë të besimit publik. Përpara figurave të partisë së tij, të mësura me fitore elektorale, Rama u ankua për "paradoksin e suksesit": sa më shumë zhvillohet dhe begatohet një shoqëri, aq më pak ajo gjykon atë që është arritur dhe funksionon, dhe aq më shumë përqendrohet te ajo që mungon dhe nuk funksionon.

Shoqëritë e varfra, tha ai, janë më tolerante ndaj mangësive, sepse mbizotëron mendësia se "mund të ishte edhe më keq". Shqipëria, sipas Ramës, e ka lënë pas këtë fazë dhe ka hyrë në një tjetër, ku mbizotëron ideja se "mund të ishte edhe më mirë".

Prandaj, sipas tij, tani nevojitet një "shtet përkujdesës", që të dëgjojë dhe marrë seriozisht përvojat e qytetarëve, të përmirësojë cilësinë e shërbimeve dhe investimeve dhe në këtë mënyrë të forcojë besimin e qytetarëve te shteti.

Fjalimi i Ramës u prit, sipas rregullit, pozitivisht nga deputetët dhe funksionarët e Partisë Socialiste. Përfaqësuesit e Lëvizjes së Flamingove e hodhën poshtë si një manovër retorike për të shmangur vëmendjen nga problemet themelore: korrupsioni, mungesa e transparencës dhe shkatërrimi i mjedisit.

Sali Berisha, kreu i opozitës konservatore nga Partia Demokratike, hodhi dyshimin se Rama kishte përdorur inteligjencën artificiale për të hartuar dokumentin 40-faqësh, të cilin e cilësoi pa përmbajtje dhe të shkruar keq.

Vetë Rama nuk të jep përshtypjen se ndihet i vënë në mbrojtje nga "Revolucioni i Flamingove". Ai pret në zyrën e tij në Kryeministri. Atletet e bardha i ka poshtë tavolinës. Me pantallonat e gjera të zeza dhe pulovrën e zezë mban çorape të zeza. Në një varëse rrobash varen fanella basketbolli që ish-lojtari i kombëtares shqiptare i ka marrë dhuratë. Dollapët dhe raftet janë të mbushura me objekte të ndryshme arti.

Rama nuk beson se vendi ndodhet në një pikë kthese, e aq më pak në një pikë thyerjeje. "Por pa dyshim është një provë

Ai thotë se përpiqet ta shohë gotën njëkohësisht gjysmë plot dhe gjysmë bosh. “Nëse dikush tjetër e sheh gotën gjysmë bosh, është në rregull. Ai sheh më pak atë që kemi arritur dhe kërkon më shumë. Ndërsa ai që e sheh gotën gjysmë plot, sheh pikërisht atë që kemi arritur.”

Në parim, sipas tij, është shenjë pozitive kur njerëzit dalin në rrugë – për biodiversitetin, për mbrojtjen e mjedisit dhe për çështje të tjera.

“Për mua është një sfidë. Por kjo është diçka e mirë. Gjatë gjithë jetës sime politike gjërat nuk kanë shkuar kurrë vërtet mirë kur nuk jam sfiduar. Zakonisht jam më i mirë kur sfidohem. A do të jem më i mirë edhe këtë herë? Shpresoj. Nuk e di. Koha do ta tregojë. E ardhmja do ta dëshmojë.”

Sa i përket shkakut të drejtpërdrejtë të protestave në rivierën shqiptare, Rama kujton se kontakti i parë me Jared Kushner dhe Ivanka Trump për një investim të mundshëm në Zvërnec dhe në ishullin e Sazanit kishte ndodhur në një kohë kur Donald Trump nuk ishte ende sërish president.

“Jeta e Trumpit në atë kohë lëkundej mes burgut dhe Shtëpisë së Bardhë.”

Rama këmbëngul se fakti që, si kryeministër shqiptar, promovon investimet e huaja direkte në vendin e tij, veçanërisht në sektorin kyç të turizmit, nuk e bën atë një vegël të Trumpit.

Dhe perspektiva e më shumë se katër miliardë eurove investime në projektet e planifikuara nga Kushner dhe partnerët e tij, thotë Rama, nuk është diçka që ai si kryeministër mund ta refuzojë thjesht, nëse mendon për interesin e vendit.

Megjithatë, sipas tij, nuk mund të flitet për një “shitje” të Shqipërisë. Ishulli i Sazanit vazhdon të jetë pronë e shtetit shqiptar dhe do të mbetet i tillë. Ende nuk është arritur asnjë marrëveshje për zhvillimin e mundshëm të ish-zonës së mbyllur ushtarake nga investitorë privatë në një resort luksoz.

Në qershor, protestat sollën një ngadalësim të vogël në rritjen e turizmit shqiptar. Tani kjo duket se është kapërcyer. Këtë vit Shqipëria pritet të regjistrojë 14 deri në 15 milionë vizitorë, krahasuar me rreth 12.5 milionë një vit më parë.

TAG:

100 ditë protestë

lëvizje masive

revolucion i flamingove

## Të ngjashme





**Skrapar/ Foshnja dëmton dorën me grirëse mishi, niset me helikopter drejt Tiranës**

**E rëndë në Itali/ Po shoqëronte vajzën për në shkollë, 42-vjeçarja shqiptare përplasët për vdekje nga kamioni**

**Shqiptarit nuk i bën punë garancia 24 mijë paund, Gjykata e Lartë angleze e lë në burg**

**Prapaskena**

**Copyrights**

**Kategoritë**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.